



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

---

Numri i lëndës: 2024:147818

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153611

K.DH.SH.II.nr.1511/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Dren Rugova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit “Telekomi i Kosovës” ShA me NUI 811288001 dhe seli në lagjen Dardani në Prishtinë, kundër të paditurit Organi i Shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Cështje Administrativ, K.A.nr.245/24 të datës 09.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.09.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh.a, me numër unik identifikues 811288001, me seli në Lagje Dardania, Prishtinë, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Cështje Administrativ, K.A.nr.245/24 të datës 09.07.2024,

## A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Cështje Administrative, është vendosur si në vijim;

I. “REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesa e paditësit “Telekomi i Kosovës” ShA me NUI 811288001 për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit IP.nr.113/2024 të datës 26.03.2024 të Organi të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës, dhe vendimit nr.01/26-259/2023-Gj të datës 26.12.2023 të së Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së parë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi, për shkak të shkelejev të dispozitave të procedurës, për shkak të vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë i gjendjes faktike, si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, dhe të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe të caktoj shtyrjen e ekzekutimi të vendimit IP nr.113/2024 të datës 26.03.2024, të paditurës-Ministria e Financave, Punës dhe Transferve/Organi i Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës dhe vendimi nr.01/26-259/2023-Gj i datës 26.12.2023

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit e paditura edhe pse të njejtën e ka pranuar me datë 07.08.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi “Telekomi i Kosovës” Sh.a, me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, ka iniciuar konflikt administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit IP.nr. 113/2024 të datës 26.03.2024 të paditurës Qeveria e Kosovës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Organi i Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës dhe vendimi nr.01/26-259/2023-Gj i datës 26.12.2023, si dhe ka kërkuar nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të kontestuara me padi deri sa gjykata të vendosë lidhur me padinë.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, gjykata shqyrtoi pretendimet e paditësit në propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën, pasi që paditësi nuk e ka provuar se me ekzekutimin e vendimit, atij do t’i shkaktohej dëm, i cili vështirë do të riparohej, si kusht i parë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, realizimi i shumës së gjobës përmes ekzekutimit të tij nuk paraqet dëm vështirë të riparushëm, pasi ai shpërblehet në të holla rrjedhëmisht ky dëm riparohet tërësisht në momentin kur paguhen (kthehen) të hollat për dëmin e njohur (eventualisht). Ndër të tjera ka cek se i padituri paraqet autoritet publik, obligimet financiare së të cilit mbulohen nga buxheti shtetëror, rrjedhëmisht paditësi do të kishte mundësi që në rrugë ligjore ta realizoj shpërblimin eventual të dëmit pa rrezik nga falimentimi i të paditurit ose nga paraqitja e ndonjë rrethane e cila do t’i vështërsonte atij shpërblimin e dëmit eventual. Po ashtu ka shtu se paditësi nuk ka ngritur pretendim për shkaktimin e ndonjë forme tjetër të dëmit, i cili vështirë do të riparohej, si dhe nuk ka paraqitur prova, nga e cila do të bëhej e besushme se do t’i shkaktohej ndonjë dëm tjetër i riparushëm, krahas formave të dëmit të trajtuara më lartë, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi nuk e ka ngritur asnjë pretendim valid së shtyrja e ekzkeutimit të vendimit të goditur nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik, por thjesht në mënyrë të përgjithshme ka deklaruar se shtyrja e ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, andaj edhe nëse nga shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ nuk do t’i shkaktohej dëm të paditurit, megjithatë kjo nuk është më relevante, përderisa kushtet tjera nuk janë plotësuar. Krejt në fund ka cek se paditësi nuk ka arritur që të argumentojnë plotësimin e tyre në mënyrë kumulative ashtu siç parashihen me dispozitën ligjore në nenin 22 par 2 të LKA-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe

sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr. IP.nr.113/2024 të datës 26.03.2024, dhe vendimit nr.01/26-259/2023-Gj të datës 26.12.2023 të lëshuar nga e paditura, deri në vendosjen meritorë të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimeve kontestuese deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve kontestuese, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Andaj, në këtë rast provat e paraqitura nga paditësi nuk lidhen me kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, por me ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, me të cilën gjykata do ti vlerësoj në fazën e shqyrtimit meritor të padisë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit, se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të akteve administrative,

e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimeve duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura, dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr. 1511/24 datë 11.09.2024

Kryetarja e Kolegjit  
Franciska Zhitija Ymeri